

NJOFTIM

Bazuar në ligjin **nr. 22/2018 “Për strehimin social”** i ndryshuar, VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.

Bashkia Vau Dejës fton të gjithë qytetarët e interesuar, që të aplikojnë për të përfituar nga programet e Strehimit Social ***“Përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme”*** dhe për programin ***“Subvencioni i qirasë në tregun e lire”***, i strehimit social.

Banorët për të aplikuar për të dyja programet, duhet të paraqiten pranë zyrës së Strehimit Social në Njësinë Administrative Bushat gjatë vitit 2026, për të regjistruar aplikimin duke u asistuar nga punonjësit e Strehimit Social në aplikim për të shmangur kështu çdo të metë në regjistrimin e kërkesës për strehim .

Kushtet për të përfituar nga programet e strehimit që do të zbatohen në Bashkinë Vau Dejës “Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme” dhe programi “Subvencioni i qirasë në tregun e lire”, i strehimit social janë:

- Të jetë banor i Bashkisë Vau Dejës;
- Të ketë mbushur moshën 18 vjeç;
- Të ketë një banesë në pronësi *(banorët që janë të interesuar për programin “Përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme”)*.
- Shtetas të huaj me qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga

organet kompetente statusin si “punëtor emigrant” dhe/ose “azilkërkues”, “rrefugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese”.

- Individët/familjet që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë të ardhura sipas përcaktimeve të nenit 3 të Ligjit nr 22/2018 i ndryshuar.

Objektet dhe banesat , që trajtohen nga programi “ Përmirësimi e kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme”janë :

- Objektet/ banesat në rrezik shembjeje;
- Objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme .

Përparësi në trajtimin me programet e Strehimit Social sipas ligjit kanë:

- a) personat me aftësi të kufizuara;
- b) individët me statusin e jetimit;
- c) familjet e policëve të rënë në detyrë;
- ç) të moshuarit;
- d) komuniteti rom;
- dh) komuniteti egjiptian;
- e) komunitetet e zonave rurale;
- ë) prindërit e vetëm;
- f) viktimat të trafikimit /viktima të mundshme të trafikimit;

Dokumentat e nevojshme për aplikim në programin “Përmirësimi i kushteve të banesës ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme” janë:

1. Aplikanti duhet të paraqitet me kopje të mjetit të identifikimit.
2. Deklaratën e vërtetësisë së informacionit paraprak të pasqyruar në formularin e strehimit, me anë të së cilës aplikuesit i bëhen të njohura edhe përgjegjësitë ligjore që ai ka në lidhje me dhënien e një informacioni dhe fakteve të rreme.
3. Çertifikatë familjare.
4. Çertifikatë personale
5. Katër(4) fotografi të banesës ekzistuese.

Dokumentat e nevojshme për aplikim në programin “Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë” janë:

1. Aplikanti duhet të paraqitet me kopje të mjetit të identifikimit.
2. Deklaratën e vërtetësisë së informacionit paraprak të pasqyruar në formularin e strehimit, me anë të së cilës aplikuesit i bëhen të njohura edhe përgjegjësitë ligjore që ai ka në lidhje me dhënien e një informacioni dhe fakteve të rreme.
3. Çertifikatë familjare.
4. Çertifikatë personale
5. Kontrata e qirasë.